



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 158 / 12 Prot.

Vlorë më, 19.03.2025

VENDIM

Nr. 36, datë 19.03.2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "KONTROLL I
SISTEMEVE ELEKTRIKE TË FUQISË"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, reorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë*" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave me nr. 951 datë 19.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit "Kontroll i Sistemeve Elektrike të Fuqisë" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DEPARTAMENTI I INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE**

**RREGULLORE
E PROGRAMIT MËSIMOR TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
"Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise"**

VLORE 2025

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

Programi mësimor "**Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise**" është program i ciklit të dytë të studimeve, ofruar nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike, Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë.

Ky program organizohet në një vit akademik (2 semestra) dhe në përfundim të tyre studentët qw grumbullojnë 60 ECTS dhe marrin diplomën: "Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise".

Neni 2

Objektivat formuese të programit të studimit

Programi i studimit "MP Operacione Industriale dhe Navale", ka si objektiv të formoj studentët për një karrierë të suksesshme inxhinierike dhe profesionistë të vërtetë, duke synuar tu japë studentëve mundësinë e dijeve më të thelluara duke i bërë ata ekspertë të sistemeve elektrike dhe të burimeve të rinovueshme ,duke rritur përvojën e tyre ,falë kjo gershetimit të mire të teorisë dhe praktikës. Programi është specifikisht i ndërtuar për të lehtësuar mësimin e mëtejshëm për të gjithë ata që aspirojnë të kenë një karrierë të suksesshme në sektorin e energjisë elektrike dhe në atë të burimeve të rinovueshme. Ky program është ndertuar bazuar në 2 aspekte ku i pari ka të bëjë me njohuri të thelluara dhe të reja të sistemeve (Rrjeta Elektrike, Microgrid, Grid, Smartgrid, Burime te rinovueshme) dhe i dyti me kontrollin e tyre.

Programi ka për qëllim:

- Të formojë ekspertë dhe specialistë cilësorë në aspektet teorike dhe vecanërisht në aftësimin praktik të tyre .
- T'i ofrojë studentëve një kuptim me të plotë se si njohuritë e marra mund te perdoren per te përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin.
- Të zhvillojë tek studentët aftësi praktike në aplikimin e teknologjive, aparateve mates,per optimizimin e rezultateve te tyre.

- Të aftësojë studentët të sintetizojnë njohuritë teorike dhe praktike në vlerësimin në mënyrë kritike të çështjeve komplekse të sistemeve të kontrollit.
- Të zbatojnë mjete, teknika dhe strategji për të identifikuar zbatimet e zgjidhjeve.
- Të edukojë studentët për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë dhe njohuritë e tyre në njëmënyrë etike dhe reflektuese.
- Të nxisë rritjen profesionale të studentëve duke i përfshirë ata në proceset e kërkimit dhe projekteve të përbashkëta.
- Të sigurojë përfshirjen e studentëve dhe realizimin në mënyrë sa më cilësore të praktikave profesionale në kompani të sektorëve të ndryshëm të cilat të shërbejnë si një mundësi për punësimin e tyre të ardhshëm.
- Të nxisë përkushtimin e stafit akademik në drejtim të përmbushjes së standarteve të etikës në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

Neni 3

Kurrikulat e programeve

Kurrikula e programit mësimor **“Kontroll i sistemeve elektrike të fuqisë”** organizohet në:

- Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme
- Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore
- Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjidhje
- LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.
- DETYRIME PËRMBYLLËSE – (Provim përfundimtar/Punim diplome).

Lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: departamentin përgjegjës për zhvillimin e kursit dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet.

Kështu, për lëndët me kode:

- “MEK ...” përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
- “EE ...” përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
- “ECN” përgjegjës për zhvillimin e tyre është Fakulteti i Ekonomisë.

Përmbajtja tematike e lëndëve, të dhënat mbi lëndën, mënyrën e vlerësimit, kontrollin e dijes, literaturën e detyruar etj, paraqiten në syllabyset përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

Neni 4

Format dhe organizimi i studimit të programit “Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise”

Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare dhe laboratore), studim individual (studim, detyra, projekte, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj).

Neni 5

Format e kontrollit të dijes

Programi mësimor “**Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise**” parashikon vlerësime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a). me shkrim,
 - b). me gojë,
 - c). i kombinuar, me shkrim dhe me gojë
- duke u mbështetur në programin mësimor.

Vlerësimi përfundimtar bëhet përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 6

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimit, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 7

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Kontrolli i njohurive bëhet me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave/projekteve të kursit.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, studenti ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi ad hoc për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e

provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brënda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.

7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 8

Format dhe organizimi i studimit të programit “Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise”

Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në:

- mësim në auditor (leksione, seminare dhe laboratore),
- studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
- përgatitje provimesh,
- përgatitje e tezës së diplomës
- praktikë profesionale.

Neni 9

Format e kontrollit të dijes dhe instrumentet e vleresimit

1. Programi mësimor “**Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise**” parashikon vlerësime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.
2. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve (me shkrim, pa pwrjashtuar edhe atw me gojë), eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomave.
3. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studenti.
4. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritët të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale.
5. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre.
6. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).
7. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:
 - d). me shkrim,
 - e). me gojë,
 - f). i kombinuar, me shkrim dhe me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor.

8. Vlerësimi përfundimtar bëhet përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.
9. Pësia (përqindja) e provimit të pjesshëm, mund të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve semestrale, të gjitha së bashku.
10. Në rastin kur studenti nuk merr pjese në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (p.sh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr dekani i fakultetit përkatës, duke u bazuar në kërkesën me shkrim së paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën.
11. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 10

Veprime të ndaluara gjatë zhvillimit të provimit të lëndës

1. Në sallën e provimit nuk lejohet përdorimi i materialeve që gjykohen si të tilla nga pedagogu i lëndës përkatëse, si p.sh kopje, telefonat celular, kufjet, etj. Këto veprime i bëhen të ditura studentit, përpara zhvillimit të provimit të lëndës përkatës mund të pasqyrohen edhe në tezën e provimit që i jepet studentit.
2. Veprim tjetër i ndaluar janë edhe komunikimet e studentit në sallën e provimit, përveç atyre raseve kur komunikimi bëhet me pedagogun e lëndës lidhur me tezën e provimit.
3. Shkelja e këtyre rregullave mund të ndëshkohet nga pedagogu ose nëpërmjet uljeve të pikëve, ose përjashtimit të studentit nga provimi dhe vlerësimit negativ për atë provim.

Neni 11

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë.

Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha lëndët e programit mësimor.

Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.

Neni 12

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

8. Kontrolli i njohurive bëhet me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave/projekteve të kursit.
 9. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
 10. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
 11. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, studenti ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
 12. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
 13. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi ad hoc për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
- Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 13

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimin përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit.

Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit.

Orari i provimeve finale/pjesshme duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë para fillimit të sezonit të provimeve (pjesshme/finale).

Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Ora mësimore zgjat 50 minuta

Neni 14

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimi përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit.

Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë pas fillimit të semestrit.

Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 15

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.

Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet.

Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët në këtë rast nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Sekretaria mësimore e DITD-së përgjigjet për administrimin e informacionit mbi frekuentimin e studentëve.

NENI 16

RREGULLAT E REGJISTRIMIT DHE ORGANIZIMI I KURSEVE

Studentët e programit mësimor **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise** regjistrohen online nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Univlora në kurset që i ofrohen sipas planit mësimor.

Çdo lëndë apo kurs ka kodin e vet të përbërë nga tre shkronja që tregojnë disiplinën apo fushën e studimit, dhe një numër treshifror.

Neni 17

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë: kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 18

Vlerësimi për diplomim

Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome.

Studentit mesatarja e përgjithshme e studimit të të cilit është 8, i njihet e drejta të realizojë punim diplome. Në rast se nuk ka student me mesatare 8 e lartë, tre studentët me mesatare të përgjithshme më të lartë, u njihet e drejta të realizojë punim diplome.

Punimet e diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë studime individuale,
- Të jenë studime eksperimentale, deskriptive apo analitike.
- Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura,
- Të ndjekin rregullat e shpallura nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) për paraqitjen e punimit, bazuar në shtojcat në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 65, datë 14.11.2016

Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe/ose me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin e studentit përmes ushtrimeve. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve bashkë.

Neni 19

Modalitetet për dhënien e diplomës

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të parë të studimeve në programin "**Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise**" janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në lëndët:
 - Bazë.
 - Karakterizuese.
 - Ndërdisciplinore/integruese.
 - Plotësuese.
2. Studenti duhet të ketë vlerësim "kalues" në provimin e formimit/tezën e diplomës.
3. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 60 ECTS (kredite).
4. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studenti paraqitet pranë sekretarisë mesimore të DITD-së për të kryer procedurat përkatëse.

Neni 20

Kuotat, tarifat dhe pranimi i studentëve në programin e studimit Master Profesional në Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise

1. Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) është përgjegjës për miratimin e kuotave, tarifave dhe kriterëve përzgjedhëse të aplikantëve për ndjekjen e studimeve në programin e studimeve "Master Profesional në **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise**".
2. Komisioni Ad-Hoc, i ngritur pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, bën përzgjedhjen e kandidatëve referuar kriterëve të miratuara nga DITD dhe kuotave në dispozicion.

Neni 21

Kreditet ECTS

1. Në programin e Studimit MP: **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise** krediti i formimit i referohet kredit të formimit sipas Sistemit European të transferimit të krediteve dhe ECTS dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.
2. Në programin e Studimit MP **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise** 1 krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.

3. Në programin mësimor MP: **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise** sasia vjetore e punës së kryer nga studenti gjatë vitit akademik është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
4. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm në rast të vlerësimit pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm/semestral me atë përfundimtar.

NENI 22

PRAKTIKA PROFESIONALE

1. Në programin e studimit MP: **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise** studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale. Me fillimin e semestrit në të cilën praktika profesionale është e parashikuar për tu zhvilluar u komunikohet studentëve koha e kryerjes, programi, mënyra e zhvillimit dhe shlyerjes së saj.
2. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione/ndërmarrje prodhimi apo shërbimi sipas proflit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti, sipas marrëveshjeve tip që lidhen për këtë qëllim. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces.
3. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.

Neni 23

Mobilitet e studentit në kuadrin e programeve ndërkombëtare të bashkëpunimit (Erasmus, projekte bilaterale etj)

1. Studenti i angazhuar në mobilitete ndërkombëtare në kuadrin e projekteve e programeve ndërkombëtare në të cilat Universiteti i Vlorës, ose Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare ka marrëveshje, lirohet nga detyrimet e frekuentimit parashikuar nga kjo rregullore, dhe rregullorja e UV-së dhe DITD-së.
2. Studentit i njihen provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndët e ngjashme dhe me kthimin në UV, duhet të shlyejë detyrimet për lëndët e tjera.

3. Vendimin për njohjen dhe ekuivalentimin e provimeve të dhëna nga studenti gjatë periudhës së mobilitetit ndërkombëtar e merr komisioni AD-HOC i ngritur pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, bazuar edhe në Learning Agreement, të firmosur me fillimin e mobilitetit

Neni 24

Ndërprerja e studimeve dhe Ripranimi

1. Studenti mund të ndërpresë studimet pasi të ketë njoftuar paraprakisht për këtë ndërprerje Dekanin.
2. Studenti mund ti rifillojë studimet para apo pas konsumimit të lejes, në fillim të cdo semestri apo në të njëjtën datë pas së cilës ai është larguar.
1. Studenti i ripranuar i nënshtrohet detyrimeve të programit mësimor që gjen pas rifillimit të studimeve.
2. Detaje të tjera mbi procedurën e ripranimit paraqiten në rregulloren e UV-së

NENI 25

Te drejtat dhe detyrimet e studenteve

1. Studentët e regjistruar në programin e studimit “MP. **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise** kanë po ato të drejta sic parashikohet në Rregulloren e UV-së
2. Studentët e regjistruar në programin e studimit “MP **Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise**” kanë po ato detyrime sic parashikohet në Rregulloren e UV-së

Shtojca 1 – Veprimtaritw Formuese nw Programin e studimit MP Kontroll i sistemeve elektrike te fuqise

Lëndë të detyrueshme				
Lëndë Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 5%-10%, (6 kredite)	1	EE 440	Përpunimi i të Dhënave në Sistemet Elektrike	6
Lëndë Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore 30% - 40% (24 kredite)	2	EE461	Njohuri të Avancuara në Makinat Elektrike	6
	3	EE446	Analiza dhe Kontrolli në Sistemet Elektrike	6
	4	EE431	Elektronikë Fuqie e Avancuar	6
	5	EE448	Pajisje dhe Sisteme Robotike Industriale	6
Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjidhje 20%-30% (16 kredite)	6	MEK 451	Energjite e Konvertueshme	6
	7	ECN-491	Ekonomi Inxhinierike	4
	8	EE471/EE472/EE473	Mbrojtja Rele në Sistemin Elektroenergjitik / Teknologjia dhe Komponentët e Rrjetave Smart/Projektimi I Rrjetave Civile dhe Industriale (lëndë me zgjedhje)	6
Lëndë Plotesuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale 10% (6 kredite)	9	EE490	Praktikë Profesionale	6
Detyrime përmbyllëse – 10% - 20% (8 kredite)	10	EE498	Mikroteza	8

Shtojca 2. Plani Mësimor – Master Profesional Operacione Industriale dhe Navale

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredi	Tot. orë / sem. Brenda & jasht auditorit	Tot. orë / sem. Brenda në auditor	Tot. orë / sem. Jashte auditorit	Totali orë / javë në auditorit			Detyra kursi
								lex	sem	lab	
Viti I	Sem. I	CS-E 431	Përpunimi i të Dhënave në Sistemet Elektrike	6	150	75	75	3	2	0	1
		EE 461	Njohuri të Avancuara në Makinat Elektrike	6	150	75	75	3	1	1	0
		EE446	Analiza dhe Kontrolli në Sistemet Elektrike	6	150	75	75	3	2	0	1
		EE431	Elektronikë Fuqie e Avancuar	6	150	75	75	3	1	1	0
		MEK 451	Energjite e konvertueshme	6	150	75	75	3	2	0	0
		TOTALI		30	750	375	375	15	8	2	2
	Sem. II	EE 448	Pajisje dhe Sisteme Robotike Industriale	6	150	75	75	3	2	0	1
		ECN 491	Ekonomi Inxhinierike	4	100	45	55	2	1	0	1
		EE471/EE472/EE473	Lëndë me zgjedhje	6	150	75	75	3	2	0	1
		EE490	Praktike Profesionale	6	150	120	30	0	5	0	0
		EE498	Mikroteza	8	200	=	200	=	=	=	0
		TOTALI		30	750	315	435	8	1	0	3
		Grand Totali		60	1500	690	810	23	18	2	5